REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno Më/Dana 30-05-2022
Nr.i organit Org.broj | Numri/broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost
01-110/05-547

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 35.1,35.2 pika (a) dhe Ligjit mbi Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, Ligjit për Arsimin Parauniversitar të Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, neni 13, Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Professional Nr.04/L-138, nenin 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491. Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 27.05.2022, merr këtë:

# V E N D I M

## Për ndryshimin-plotësimin e emrit të shkollës së Mesme Profesionale

**Neni 1**

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin që, Shkolla e Mesme Profesionale tash e tutje, në vend të emërimit të tashëm Shkolla e Mesme Profesionale (SHMP) „Jonuz Zejnullahu''në Viti, tani e tutje të emërtohet si: **Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP)** „Jonuz Zejnullahu''në Viti.

**Neni 2**

Ky vendim miratohet me kërkesën e Drejtorisë për Arsim të Komunës së Vitisë, duke u bazuar në rekomandimin e Divizionit për Arsim dhe Aftësim Profesional (DAAP), në kuadër të MASH-it, ku kërkohet që formulari i institucioneve arsimore të shkollave, Divizionit për Arsim dhe Aftësim Profesional (DAAP) në kuadër të MASH-it, Divizionit për Arsim dhe Aftësim Profesional (DAAP) në kuadër të MASH-it profesionale, duhet të jetë i njëjtë në nivel vendi si institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP).

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim, Zyra e Kryetarit të Komunës së Vitisë.

**Neni 4**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:
1. Drejtorisë së Arsimit
2. Zyrës së Kryetarit
3. MAPL-së
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I
Bekim Azizi